



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 56 (827810)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes


E premte, 10 shkurt 2023

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer, vizitë zyrtare në Shqipëri

Me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë. Në vizitën e zhvilluar në Ministrinë e Mbrojtjes, ai u prit me nderimet më të larta ushtarake nga gjeneral brigade Kingji. Admiral Bauer gjatë takimit me gjeneral brigade Kingjin, e falënderoi atë për mikpritjen e përzemërt si dhe i shprehu mirënjohjen për mundësinë e njohjes nga

afër me kapacitetet ushtarake të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Gjatë takimit, ai vlerësoi maksimalisht rolin dhe kontributin e vendit tonë në NATO. "Shqipëria është një aleat i vyer. Në këtë epokë të re të mbrojtjes kolektive, ne jemi më të fortë së bashku. Vendi juaj jep kontribute jetësore në NATO, jo vetëm në angazhimet në misionet paqeruajtëse në KFOR, në Kosovë dhe Irak, po ashtu kontribuon me trupa në grup-batalione shumëkombëshe në Letoni dhe Bullgari.

Ky është një komponent i rëndësishëm i shkurajimit dhe mbrojtjes së NATO-s në krahun lindor të Aleancës", - u shpreh ndër të tjera admiral Bauer. Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji falënderoi admiralin Bauer për vlerësimet e larta për rolin dhe kontributin e FARSH në operacionet e NATO-s, duke u shprehur ndër të tjera: "Ne jemi krenarë që shërbejmë sot me dinjitet në vijën e parë të frontit të Aleancës, në... >> faqe 2



TËRMETI NË TURQI

Ministri Peleshi: Së bashku në ditë të vështira në emër të jetës



Përfundon në Forcën Tokësore "Junior Command and Leadership Course"

Në ambientet e sallës së konferencave të Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit "Junior Command and Leadership Course". Pjesëmarrës në ceremoni ishin zëvendës ambasadorja e Britanisë së Madhe në vendin tonë, znj. Camilla Marzouk, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, atashu ushtarak britanik në vendin tonë, nënkolonel Timothy Right-Boycott, komandanti i grupit britanik të trajnimit "British Military Advisory Training Team" (BMATT), kolonel Paul Morris etj. Ceremonia...



>> Faqe 4

Zhvillohet ceremonia e fillimit të stërvitjes vjetore nga Forca Detare për vitin 2023


Në Bazën Detare Pashaliman është zhvilluar ceremonia e fillimit të stërvitjes vjetore të Forcës Detare për vitin 2023. Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishte komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, i cili gjatë fjalës përshëndetëse vlerësoi punën e palodhur të deritanishme dhe i uroi suksese efektivitetit pjesëmarrës në vijim të këtij cikli stërvitor. Stërvitja do të zhvillohet nga të gjithë repartet dhe nënrepartet në nivel anije, grup anije si dhe Grup i Bordingut të Forcës Detare. Kjo stërvitje është ndër...




>> Faqe 5

'Yjet e pashuar të Fekenit'

Tragjedia e stërvitjes dimërore të 6 shkurtit 1981 ishte një ngjarje e shkruar në memorien e gjithë ushtarakëve shqiptarë, por edhe më gjerë. Ishin tre oficerë dhe tetë studentë të ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, që në kujtesën shqiptare quhen "11 dëshmorët e Meçekut". Stërvitja dimërore masive e trupës studentore dhe pedagogjike, në një ditë tepër të vështirë, u kthye në një ditë që në memorien ushtarake shqiptare dhe më gjerë është quajtur "Tragjedia e Fekenit", rrëzë malit të Meçekut. Tashmë janë të rrallë...



>> Faqe 6-7



Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer, vizitë zyrtare në Shqipëri

Me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë.

Në vizitën e zhvilluar në Ministrinë e Mbrojtjes, ai u prit me nderimet më të larta ushtarake nga gjeneral brigade Kingji.

Admiral Bauer gjatë takimit me gjeneral brigade Kingjin, e falënderoi atë për mikpritjen e përzemërt si dhe i shprehu mirënjohjen për mundësinë e njohjes nga afër me kapacitetet ushtarake të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Gjatë takimit, ai vlerësoi maksimalisht rolin dhe kontributin e vendit tonë në NATO.

“Shqipëria është një aleat i vyer. Në këtë epokë të re të mbrojtjes kolektive, ne jemi më të fortë së bashku. Vendi juaj jep kontribute jetësore në NATO, jo vetëm në angazhimet në misionet paqeruajtëse në KFOR, në Kosovë dhe Irak, po ashtu kontribuon me trupa në grup-batalione shumëkombëshe në Letoni dhe Bullgari. Ky është një komponent i rëndësishëm i shkurajimit dhe mbrojtjes së NATO-s në krahun lindor të Aleancës”, - u shpreh ndër të tjera admiral Bauer.

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji falënderoi admiralin Bauer për vlerësimet e larta për rolin dhe kontributin e FARSH në operacionet e NATO-s, duke u shprehur ndër të tjera: “Ne jemi krenarë që shërbejmë sot me dinjitet në vijën e parë të frontit të Aleancës, në këto kohë të vështira, kur siguria është e kërcënues, të rreshtuar përkrah aleatëve në Letoni, Bullgari e deri në Kosovë”, - u shpreh gjeneral Kingji.

Më tej, takimet e admiral Bauer vijuan me krenari më të lartë të qeverisë, ai u prit nga Presidenti i Republikës, z. Bajram Begaj, Kryeministrin i Shqipërisë, z. Edi Rama, dhe ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi.

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, në takimin me kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer, e falënderoi për vizitën në Shqipëri në këtë kohë sfidash për paqen dhe sigurinë në hapësirën euroatlantike, si pasojë e agresionit të paligjshëm të Rusisë ndaj Ukrainës. Presidenti Begaj



vlerësoi Adminalin Bauer për drejtimin me vizion dhe përkushtim të Komitetit Ushtarak dhe kontributin që Komiteti Ushtarak jep në drejtim të përshtatjes dhe forcimit të kapaciteteve dhe kohezionit të aleancës.

Kreu i Shtetit bëri me dije se, Shqipëria mbetet e angazhuar në misionet dhe operacionet të NATO-s, ka rritur kontributet për vitin 2023 në KFOR, dhe është e gatshme për rritjen e tyre nëse do të jetë e nevojshme. Shqipëria qëndron në krah dhe do vijojë të mbështesë Ukrainën në aspektin politik, diplomatik dhe ushtarak.

Në vijim, Presidenti Begaj vlerësoi angazhimin e NATO-s në rajon dhe rolin e misionit të KFOR-it në ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Shqipëria mbështet dialogun ndërmjet Serbisë dhe Kosovës të ndërmjetësuar nga BE dhe mbështetur nga SHBA-të në drejtim të arritjes së një marrëveshjeje, Kosova që nga viti 2008 është e pavarur dhe me vizion të qartë euroatlantik dhe në

këtë kontekst mbështet një bashkëpunim akoma më të ngushtë dhe të thelluar me NATO-n.

Kreu i Shtetit diskutoi edhe lidhur me sulmin kibernetik të sponsorizuar nga Irani ndaj Shqipërisë dhe vlerësoi bashkëpunimin me NATO-n për rikuperimin nga ky sulm. Në këtë drejtim Presidenti Begaj vlerësoi thellimin e bashkëpunimit dhe kontributit që struktura, agjenci dhe entitete të NATO-s mund të japin në drejtim të forcimit të mbrojtjes kibernetike, përfundimtare që do çojë në njohje reciproke.

Ndërsa në takimin me kryeministrin shqiptar, z. Edi Rama, admiral Bauer u fokusua në rëndësinë e qëndrueshmërisë kibernetike dhe angazhimin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor.

Kryetari nënvizoi rolin pozitiv që Shqipëria po luan për të promovuar paqen dhe

stabilitetin në rajon. “Vlerësoj angazhimin e Shqipërisë për të promovuar stabilitetin dhe bashkëpunimin në të



gjithë Ballkanin Perëndimor. Kontributet e Shqipërisë në NATO forcojnë jo vetëm sigurinë rajonale, por edhe atë evropiane”, - shtoi ai.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e vlerësoi këtë vizitë si mjaft të rëndësishme në një kohë të trazuar për situatën e mbrojtjes dhe sigurisë, jo vetëm në kontinentin evropian, por në të gjithë botën mbarë.

Më tej ministri i Mbrojtjes e përgëzoi kreun e Komitetit Ushtarak për liderhipin e treguar deri më tani me autoritetet më të larta ushtarake të NATO-s si dhe për këshillat ushtarake mjaft të vlefshme dhe profesionale, të marra nëpërmjet konsensusit të të gjithë vendeve anëtare dhe rëndësinë e tyre në vendimmarrjen politike.

Ministri Peleshi theksoi mbështetjen e pakursyer të vendit tonë në aspektin politik, diplomatik, ushtarak dhe ekonomik si dhe vijimin e kësaj mbështetjeje brenda mundësive dhe kapaciteteve tona për atë kohë sa të nevojitet.

Gjithashtu, ministri Peleshi garantoj kreun e Komitetit Ushtarak për përm-bushjen e zotimit për arritjen e Buxhetit të Mbrojtjes në 2% deri në vitin 2024, ndonëse kjo shifër, për situatën aktuale të sigurisë, nuk është e mjaftueshme.

Një vëmendje të veçantë gjatë bisedës mori edhe situata e sigurisë në Kosovë, e cila nuk duhet lënë jashtë vëmendjes së Aleancës, atëherë më tepër në një kohë kur retorika pro ruse në Ballkan shtohet dita-ditës.

Në përfundim të takimit, të dy bashkëbiseduesit ranë dakord për të

zbatuar vendimet e marra nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve të NATO-s gjatë Samitit të Madridit, vitin e kaluar, por edhe për çështjet që do të diskutohen në Samitin e ardhshëm në Vilnius, Lituani, më 11 - 12 korrik 2023.

Kryetari vizitoi gjithashtu Regjimentin e Operacioneve Speciale të Zall-Herr, ku vëzhgoi drejtpërdrejt një demonstrim të Forcave të Operacioneve Speciale Shqiptare. “Më bëri përshtypje shfaqja e bërë sot nga bashkimi më elitari i Shqipërisë, ata demonstuan unitetin e qartë të qëllimit, profesionalizmin dhe jetuan në përputhje me reputacionin e tyre ndërkombëtar”, theksoi në fjalën e tij admiral Bauer.

Më tej admiral Bauer iu drejtua anëtarëve të kurseve të nivelit të lartë në

Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë të Forcave të Armatosura Shqiptare, ku theksoi rëndësinë e të qenit i përgatitur dhe i gatshëm për t'u përshtatur dhe për të pritur të papriturën. Admiral Bauer tha se: “Trupat shqiptare ndihmojnë për të mbajtur Aleancën tonë të sigurt. Këta ‘bija dhe bija shqiptonjash’ e ndihmojnë Aleancën të ngrihet lart. Ata janë të gatshëm t'i vënë të gjitha në linjë për të mbështetur rendin e bazuar në rregulla ndërkombëtare, për të promovuar demokracinë dhe për të krijuar siguri dhe stabilitet për vendin e tyre. Shqipëria është një aleat e vlerësuar. Në këtë epokë të re të mbrojtjes kolektive, ne jemi më të fortë së bashku.”

TËRMETI NË TURQI

Ministri Peleshi: Së bashku në ditë të vështira në emër të jetës

Qeveria shqiptare i është përgjigjur menjëherë thirrjes për ndihmë, pas tërmetit shkatërrimtar në kufirin midis Turqisë dhe Sirisë, që shkaktoi viktima të shumta, të plagosur dhe dëme të konsiderueshme.

Një mision ndihme nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, në përbërje të të cilit janë personel mjekësor, specialistë të kërkim - shpëtimit si dhe 7 mjete kanë mbërritur në Turqi, dhe po marrin pjesë në operacionet e kërkim - shpëtimit, për të lehtësuar sadopak pasojat e kësaj tragjedie.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi shprehu mirënjohjen edhe në emër të kryeministrit Edi Rama dhe qeverisë shqiptare për të gjithë personelin që po angazhohet në këtë operacion.

“Tronditje dhe trishtim për qindra viktima dhe mijëra të plagosur që shkaktoi tërmeti shkatërrimtar, në Turqi dhe Siri. Jemi me zemër dhe mendje pranë familjeve të viktimave. Shërim të shpejtë të lënduarve!

Të gatshëm të ndihmojmë me kapacitetet tona për rikuperimin sa më shpejt të pasojave. Ky është një kontribut që i kthehet Turqisë, e cila e ka ndihmuar Shqipërinë vazhdimisht edhe gjatë tërmetit të 26 nëntorit 2019. Së bashku në ditë të vështira në emër të jetës”, - u shpreh ministri Peleshi.

Skuadrat e kërkim - shpëtimit të Shqipërisë po vijojnë operacionet në zonat e prekura nga tërmeti i 6 shkurtit.

Një pjesë e skuadrës është vendosur në zonën e Malatya, në Turqi, në kushte tejet të vështira për shkak të rrënojave të ndërtesave të larta, por edhe motit me temperatura të ulëta, efektivet e Forcave të Armatosura po punojnë pa pushim për nxjerrjen e të



mbijetuarve apo trupave të viktimave që humbën jetën nga tërmeti i së hënës.

Gjatë ditës së hënë pjesëtarët e skuadrës shqiptare, në koordinim të plotë me autoritetet vendase dhe ekipet aleate nga Mekanizmi Evropian i

Mbrojtjes Civile kanë ndihmuar në nxjerrjen e 3 trupave të pajetë, ndërsa është shpëtuar një fëmijë 5 vjeç, i cili ishte në gjendje të mirë shëndetësore pavarësisht orëve të gjata nën rrënoja.

Misioni ka vijuar pa ndërprerje

ditë dhe natë. Deri më tani me ndihmën edhe të pjesëtarëve të skuadrës shqiptare të kërkim - shpëtimit janë nxjerrë 3 trupa të tjerë.

Pjesëtarët e ekipit tonë shëndetësor kanë asistuar edhe në dhënien e ndih-

mës shëndetësore për dhjetëra persona të lënduar. Skuadrës së parë të kërkim - shpëtimit nga Shqipëria iu bashkuan të tjera forca shtesë, për të mbështetur autoritetet turke në përballimin e pasojave të tërmetit të 6 shkurtit.



Në ambientet e sallës së konferencave të Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit “Junior Command and Leadership Course”. Pjesëmarrës në ceremoni ishin zëvendës ambasadorja e Britanisë së Madhe në vendin tonë, znj. Camilla Marzouk, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, atashëu ushtarak britanik në vendin tonë, nënkolonel Timothy Right-Boycott, komandanti i grupit britanik të trajnimit “British Military Advisory Training Team” (BMATT), kolonel Paul Morris etj.

Ceremonia, u hap nga instruktorët britanikë të BMATT, me një prezantim përmbledhës mbi aktivitetin e zhvilluar gjatë periudhës njëmuajore, të këtij kursi. Ceremonia, u hap nga instruktorët britanikë të BMATT, me një prezantim përmbledhës mbi aktivitetin e zhvilluar gjatë periudhës njëmuajore, të këtij kursi.

Më pas, aktivitetin e përshëndeti zëvendës ambasadorja e Britanisë së Madhe në vendin tonë znj. Camilla Marzouk, e cila përgëzoi të gjithë pjesëmarrësit në kurs, për përfundimin e tij me sukses, duke uruar që trajnimi i përfunduar do të vlejë jo vetëm për karrierën e tyre ushtarake, por edhe më tej në jetën e tyre shoqërore, për t'i bërë ata qytetarë edhe më të denjë të shoqërisë ku jetojnë.

Kolonel Paul Morris, komandanti i BMATT, duke marrë fjalën shprehu urimet e tij më të mira për të gjithë kursantët, duke vlerësuar përgatitjen e tyre profesionale, qëndrueshmërinë dhe disiplinën e treguar gjatë periudhës së zhvillimit të trajnimit.

“Ky është vetëm fillimi i karrierës tuaj, ndaj do të kërkoja nga ju, që njohuritë e marra këtu t'i shpërndani edhe në repartet ku ju shërbeni. Mos harroni të bëni gjënë e duhur, në momentin më të vështirë...”, - u shpreh kolonel Paul Morris.

Të pranishmit u përshëndetën edhe nga zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo. Në fjalën e tij, drejtuar të pranishmëve ai shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij për palën britanike për zhvillimin e kursit “Junior Command and Leader-



Përfundon në Forcën Tokësore “Junior Command and Leadership Course”



ship Course”, duke e vlerësuar këtë, si një tregues i bashkëpunimit shumë të mirë, që ekziston mes dy ushtrive tona mike dhe aleate në NATO.

Më tej, duke iu drejtuar kursantëve të sapo certifikuar, gjeneral brigade Dimo, duke i falënderuar për përkushtimin e treguar, kërkoi nga ata që tempin e lartë të përgatitjes profesionale të treguar gjatë kursit, të vijojnë ta mbajnë edhe në të ardhmen. “Ju sot përfunduat

një kurs të rëndësishëm për karrierën tuaj. Natyrisht që ky nuk duhet të jetë fundi, por vetëm fillimi i rritjes tuaj profesionale. Le të jetë ky kurs një gur i sigurt themeli në karrierën tuaj. Në repartet ku do të shërbeni, vijoni të shfaqni më të mirën tuaj, duke i venë në praktikë dijet dhe njohuritë e fituara gjatë kursit me instruktorët britanikë...”, - tha ndër të tjera gjeneral brigade Dimo.



Më herët gjeneral brigade Dimo priti në një takim kortezie zëvendës ambasadorën e Britanisë së Madhe në vendin tonë znj. Camilla Marzouk.

Ceremonia vijoi me ndarjen e certifikatave dhe u mbyll me një foto të përbashkët.

Kursi “Junior Command and Leadership Course” u zhvillua për një periudhë gati njëmuajore në Forcën Tokësore me pjesëmarrjen e ushtara-

këve të rolit bazë oficer dhe nënoficer.

Ky kurs u zhvillua nën drejtimin e instruktorëve britanikë të “British Military Advisory Training Team” (BMATT) dhe synon rritjen e aftësive profesionale, me fokus ato të lidershit ushtarak të rolit bazë oficer dhe nënoficer.

Nga 31 pjesëmarrës në fillim të kursit, vetëm 24 prej tyre arritën të certifikohen.

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia merr pjesë në workshopin për OHDACA.

Qëllimi i këtij workshop-i të organizuar nga UESEUCOM dhe ODC është prezantimi i mbështetjes nëpërmjet projekteve HMA për Komandën Mbështetëse, në fushën e pajisjeve dhe trajnimeve për kompaninë EOD, EC si dhe rikonstrukcionin e tuneleve të municioneve në depot Mirak dhe ndërtimin e poligonit EOD.

Në fjalën përshëndetëse, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia falënderoi SHBA-të për asistencën e dhënë si në fushën e trajnimeve dhe të pajisjeve, duke shprehur se ky bashkëpunim do të jetë edhe në të ardhmen në të njëjtat nivele, duke siguruar që vendi ynë do të jetë gjithmonë një aleat i besueshëm në misionin e përbashkët të mbrojtjes.

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia merr pjesë në workshopin për OHDACA



Komandanti i Rojës Bregdetare Italiane, nënadmiralet Nicola Carlone zhvilloi një vizitë në Forcën Detare

Në kuadër të bashkëpunimit midis dy palëve me Rojën Bregdetare italiane, nënadmiralet Nicola Carlone zhvilloi një vizitë zyrtare në komandën e Forcës Detare. Nënadmiralet Carlone u prit nga komandanti i Forcës Detare kundëradmiralet Adnand Agastra, i cili i uroj mirëseardhjen dhe e falënderoi për bashkëpunimin e deritanishëm me Rojën Bregdetare italiane.

Qëllimi i kësaj vizite ishte rritja e bashkëpunimit dypalësh ushtarak midis dy Rojeve Bregdetare të dy vendeve dhe vlerësimi i mundësive për shtimin e bashkëpunimit të mëtejshëm me interes të përbashkët në fushën e Kërkim-Shpëtimit, si trajnime dhe stërvitje.

Në vijim të vizitës në Forcën Detare, nënadmiralet Carlone zhvilloi një vizitë në ambientet e QNOD (Qendra e Vëzhgimit Detar), në të cilën u njoh me strukturën dhe organizimin, gjithashtu realizoi dhe një vizitë në anijet e klasit "Iliria".

Ndërsa vlerësoi nivelin e detarëve tanë, nënadmiralet Carlone falënderoi komandantin e Forcës Detare për mikpritjen e treguar gjatë vizitës së tij në Shqipëri.



Përfundimi i urës në Krujë

Banorët e fshatit Mafsheq, të Njësisë Administrative Cudhi, bashkia Krujë, tashmë do të kenë një urë të re, pasi specialistët e kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios në Komandën Mbështetëse, bënë të mundur ndërtimin e saj në një kohë rekord. Ura që përfundoi në fillim të kësaj jave, shërben për banorët e fshatit Mafsheq dhe për 500 banorët e fshatrave Qezë dhe Shkretë të Njësisë Administrative Cudhi.

Kjo urë, me gjatësi 15 m me seksion 2/1 dhe me një peshëmbajtje deri në 40 ton, më së shumti do t'iu vijë në ndihmë fëmijëve të shkollës 9-vjecare dhe do të përmirësojë cilësinë e jetës së banorëve të zonës.



Në Bazën Detare Pashaliman është zhvilluar ceremonia e fillimit të stërvitjes vjetore të Forcës Detare për vitin 2023.

Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishte komandanti i Forcës Detare, kundëradmiralet Adnand Agastra, i cili gjatë fjalës përshëndetëse vlerësoi punën e palodhur të deritanishme dhe i uroi suksese efektivit pjesëmarrës në vijim të këtij cikli stërvitor.

Stërvitja do të zhvillohet nga të gjithë repartet dhe nënrepartet në nivel anije, grup anije si dhe Grup i Bordigut të Forcës Detare.

Kjo stërvitje është ndër aktivitetet kryesore të Forcës Detare, e cila është garant në suksesin e zhvillimeve të stërvitjeve para dislokuese, për pjesëmarrjen e Forcës Detare në Operacionet e NATO-s, FOCOPS dhe në operacionin në Detin Egje.

Prej shumë vitesh Forca Detare stërvitet sipas standardeve të NATO-s,

Zhvillohet ceremonia e fillimit të stërvitjes vjetore nga Forca Detare për vitin 2023



në të cilat përfshihen aktivitetet stërvitore brenda dhe jashtë vendit dhe vizitat që realizohen në vendin tonë me stërvitjet

e përbashkëta, si qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë, e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e sigurisë Detare.



'Yjet e pashuar të Fekenit'

Tragjedia e stërvitjes dimërore të 6 shkurtit 1981 ishte një ngjarje e shkruar në memorien e gjithë ushtarakëve shqiptarë, por edhe më gjerë. Ishin tre oficerë dhe tetë studentë të ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, që në kujtesën shqiptare quhen “11 dëshmorët e Meçekut”. Stërvitja dimërore masive e trupës studentore dhe pedagogjike, në një ditë tepër të vështirë, u kthye në një ditë që në memorien ushtarake shqiptare dhe më gjerë është quajtur “Tragjedia e Fekenit”, rrëzë malit të Meçekut. Tashmë janë të rrallë ushtarakët që e kanë jetuar ditën e tragjedisë së ushtarakëve të ish-SHLBO dhe që militojnë në FASH. Megjithatë kujtesa e shqiptarëve nuk mund të harrojë ushtarakët, studentët e pedagogë me në krye komandantin e shkollës, Rustem Peçi, shefin e degës mësimore Hysen Shehu e shumë të tjerë, personalitete të shquar ushtarakë, një simbolikë solidariteti ushtarak e njerëzor. Katër dekada e gjysmë kanë shkuar dhe Lapidarët e Fekenit si maja malesh lartësohen në të katër anët e Shqipërisë. Që të gjithë ranë në emër të një kauze të madhe në zemër të malit të Meçekut mbrapa malit të Dajtit në Tiranë. Kjo është dokumentuar në kujtesën e mijëra pjesëmarrësve në stërvitje dimërore studentë e oficerë, por edhe atyre që me zemër e shpirt ishin në stërvitjen dimërore të studentëve ushtarakë. Një korpus ushtarakësh në unitet vlerash njerëzore. Kështu është regjistruar tashmë jo vetëm në kujtesën e ushtarakëve ngjarja e rëndë tragjike, ku humbën jetën 11 pedagogë e studentë ushtarakë, gjatë një stërvitjeje dimërore në malin me borë përtej Dajtit.

Kështu do t'i sjellin ata me kujtimet e tyre për të mos u harruar kurrë kolegët shokët dhe miqtë e tyre, të cilët mbeten përjetësisht yje të pashuar.

Orteku u mori shokët por jo kujtimin për 'at'

Shpend Topallaj kujton: “..Aty nga fundi i Gushtit 1960, kisha ardhur nga Tirana, këtu në Durrës, për të takuar prindërit që ishin me pushime dhe të shfaqja edhe njëherë pakënaqësinë time, ngaqë të nesërmen duhej të filloja mësimin në shkollën e mesme ushtarake ‘Skënderbej’, ndërkohë që më qe mbushur mendja për të vazhduar liceun për pikturë, për të cilin kisha prirje. Për një fëmijë trembëdhjetë vjeçar kjo qe më se normale, por prindërit, dëshira ime i kish vënë në siklet. Kur dolën të më përcillnin tek stacioni i Plepave, kur asokohe ndalonte treni, mes turmës që priste, na zuri syri tre skënderbegas të vegjël. Ju afroam dhe pasi babai u tha se ishte oficer, i pyeti për emrat dhe nga ishin. Ai më i shkurtri tha se e quanin Çlirim dhe qe i biri i oficerit Halil Pulaj. Babai i gëzuar, ngaqë kolonel Halilin e kish shok e koleg pune u tregoi rastin tim që e kisha me pishmanllëk shkollën e tyre. Përsëri u hodh Çlirimi, i cili serioz si një i madh, tha se kjo shkollë është më e mira në Shqipëri, se ajo vërtetë përgatit kuadrot e ardhshme për ushtrinë, por aty përkrahen e inkurajohen të gjithë ata që duan artin e letërsinë. Në vazhdim ai numëroi disa poetë, shkrimtarë e artistë që kishin dalë nga bankat e shkollës ‘Skënderbej’. Për të gjitha këto



përfundoi Çlirimi, ti do të bindesh vetë, ashtu siç do të bindesh se më i bukuri nga të gjithë artet, është ai i mbrojtjes së Atdheut. Premtoi se do të më priste të nesërmen në postbllok dhe u ndamë. Çlirimi ish nga ata që e mbante fjalën: qe i pari njeri që më priti e më përqafoi tek dera e shkollës, e ushtrisë ku do të kaloja vitet më të mrekullueshme të jetës sime. Limua ishte një vit para meje, por mua më çudiste autoriteti e respekti që ai gëzonte tek shokët e eprorët. Duke parë pavendosmërinë time, ai jo vetëm që më mbante përherë pranë, por dhe u lutej oficerëve, të cilët përherë e dëgjonin, që të më lejonin të shkoja në shtëpi që të mos mëzitesha.

Dhe meqenëse kishin të njëjtin trup, gjersa na qepën tonat, më jepte për të veshur uniformën e tij të lirdaljes. Në njëfarë kuptimi, ai qysh atëherë, u bë me këshillat e tij, jo vetëm shok, por dhe edukatori im. Ashtu si Çlirimi, unë njoha shumë shokë të mirë: midis tyre dhe shokun e klasës Nikollaq Beron. Ky djalë i thjeshtë Berati, gjithmonë i qeshur e i përzemërt, me urtësinë, thjeshtësinë e sinçeritetin e tij, që nxehej veç kur ish fjala për të mbrojtur të vërtetën, kish fituar dashurinë e tërë shokëve. Nikollaqi ish i gatshëm të ndihmonte këdo, pa u mburrur kurrë për këtë, ndaj dhe kudo ku ka shërbyer, nuk e heqin nga goja, se kudo që shkeli këmba e njeriut të mirë edhe gjurma e tillë mbetet. Me zemër të madhe qe edhe komandanti i batalionit, Dushan Shameti, oficeri që kish zgjedhur për lajtmotiv, vargjet e heroit të popullit Ali Demi: ‘Më jep fuqi që të qëndroj/Më jep guxim që të luftoj/ Më çon në sulm me vrap të shkoj/ Me nder të vdes me nder të rroj’, dhe që i zbatoi ato pa hezitim gjersa dha frymën e fundit’.

Po çfarë ndodhi atë 6 shkurt të vitit 1981

Kronologjia e kësaj ngjarje tani thuajse njihet nga të gjithë. Shkolla e oficerëve kish dalë në fushimin dimëror. Ai që nuk ka qenë ndonjëherë në ato vende, pra ai që malin imponant të Dajtit, e sheh si një dekor piktoresk e tërheqës në sfondin e kryeqytetit, as që mund ta përfytyroj se ç’ ashpërsi, ç’ i ftohtë e ç’ thyerje konfiguracionit të terrenit të pret atje. Pas butësisë së Dajtit, fshihet një botë tjetër; aty nis shtrirja e pafund e kodrave e maleve që palë - palë shkojnë drejt veriut. Po të mendosh se vetëm mali i Meçekut arrin kuotën mbi 1827 m, e kupton se s’ka asnjë ndryshim nga Korabi e Jezerca. E ja këtë mal me pjerrësi herë - herë 75°, ndërsa frynte një erë e marrë me shpejtësi 40 m në sekondë, kish zgjedhur për të ngjitur nënreparti që udhëhiqej nga pedagogu Mark Mici.

Në pamje të parë sikur nuk ta mbushte syrin ky burrë i hequr, biond, me sy bojë qielli, me mjekrën pak të dalë që gjithmonë bënte shaka, nga të cilat qeshte edhe vetë me gjithë shpirt. Por po ta njihje nga afër do të mahniste me forcën, vullnetin, rezistencën, shkathëtsinë e optimizmin e tij. Ai pa u lodhur i printe kolonës gjersa mbërritën në lartësinë 1400 m. Papritur një heshtje kërcënuese e cila sikur paralajmëronte diçka të keqe pllakosi anë e mbanë. Nuk vonoi shumë dhe një masiv i madh dëbore me zhurmë filloi të rrëshqasë poshtë. Marku e dinte, se pamje të tilla ishin interesante po t’i shikoje në televizor, se në të vërtetë ajo paraqiste një rrezik të madh për jetën e atyre që s’kishin ku të futeshin. Pa humbur kohë ai thirri: “Orteku-mbrohuni!” Po ku të mbroheshin. Sa hap e mbyll sytë, llava i përfshiu të gjithë. Vetëtimthi pyetën veten: Ç’po ngjiste kështu me ta? Një

natë më parë qeshën e kënduan gjer në mes të natës. Sot që bora kishte mbërritur gjer në brez, ngjiteshin përpjetë me shkathtësinë e ketrit. Kishin shpirt poeti, ndaj i gëzoheshin bardhësisë verbuese të dëborës.

Dikush nën zë edhe recitonte: ‘Dëborë bie në pyllin plak’, apo: “Ç’u zunë rrugët me dëborë/ Pranë teje s’mund të vij/ Rri dritareve me orë/Në mendime futur rri”.

...Qenë të rinj dhe dikush mendonte për të dashurën, e dikush kish të drejtë të ëndërronte. Por s’qe e thënë: bora paska, si çdo gjë, dhe anën tjetër të saj, atë të tmerrshme, atë të papërballueshme, atë vrastaren që mbuloi gjithçka... Kur çdo gjë kaloi i pari që u çua qe pedagogu. Ku jeni vëllezër? Dhe me vrull nisi të kërktojë. Pa pushim. Me ngulç. Me dhembje. Dhe sapo i zbulonte, i udhëzonte të kërkonin të tjerët. Pastaj gjeti automatikun dhe zbrazi një krehër të tërë. Kudo u dha alarmi: “Shokët janë në rrezik”. U dëgjuan urdhra e komanda të prera. Por dhe pa ato, ata do të ngjiteshin përpjetë malit, pa ndalur asnjë çast, mjaft të fitonin edhe një sekondë të vetme. Dashuria për shokët u jepte forcë. Në krye udhëhiqnin oficerët, Çlirimi, Dushani, Nikollaqi, Petrit Murzaku, Abaz Çipini, Sali Zhakupi, Muzafer Kambo. U ngrit nga shtrati ku dergjej i sëmurë edhe studenti Nexhip Çopa nga fshati Seferaj. Filloi lufta për jetën. Luftonte vëllai për të shpëtuar vëllain, thuajse qenë ngjallur vëllezërit Dioskurë, Poluksi dhe Kastori, të njohur për trimërinë që treguan në fushatën e argonautëve, kur anijen e tyre e zuri stuhia.

Dëshmitarët tregojnë:

Kur zbuluan studentin Besnik Shehu, Çlirimi ia mori kokën dhe ia mbështeti me dashuri në gjoks. Kujtonte se ishte gjallë dhe donte ta ngrohte me

zjarrin e zemrës së tij. Ai as që mund ta merrte me mend se ç’do të ndodhte pas pak me vetë atë. Aty ku mbi kanosjen e pengesat e dëborës, triumfante dëshira për të shpëtuar shokun, e cila ndërthurej si rrallë herë me trimërinë e mospasjes frikë nga vdekja, shquhej si një luan i vërtetë, sportisti universal, rezultativi i papërsëritshëm, legjendari dhe i urti Petrit Murzaku, i cili u jepte frymë nga fryma e tij, studentëve, tamam si të qenë bijtë e tij. Një varg me studentë e kuadro ngjitej e vargu tjetër zbriste me shokët e plagosur në krah derisa panë se mungonte vetëm njëri Aleko Gjoni. O burra, përsëri, të gjejmë e shpëtojmë shokun. Por...paskej qenë ditë e mallkuar: një ortek i dytë, një masiv i tmerrshëm dëbore, prej mijëra metra kub, filloi të lëvizte me furi drejt studentëve dhe oficerëve si për t’u hakmarrë për mposhtjen e ortekut të parë. Dhe ashtu me ulërimë dhe zhurmë që vinte nga thyerja e pemëve, dëbora mbuloi gjithçka, siç mori me vete rrëshqanthe këdo që gjeti aty, pa pyetur as për herkuljanin Petja, të cilin, pasi e zhvendosi nëpër shkrepë rreth 350m, i mbetën jashtë vetëm gishtat. Po të tjerët ku ishin? Nisi puna nga e para me vrull të paepur. Me shumë mund shokët gjendeshin, por tani të gjakosur, me plagë, pa ndenja dhe o zot! Sa shumë të vdekur.

Vladimir Duro tregon: “Komandant Dushanin e gjetëm rrëzë një peme. Nga e çara e thellë e ballit i rridhte gjaku që i kish mbuluar fytyrën. Mendohej të ngrihej në këmbë. I vura kokën në gjoks dhe i thirra i mallëngjyer ‘Komandant Dushani! Komandant Dushani!’ Më rrodhën lot për komandantin tonë aq të dashur, me të cilin një natë më parë, gati gjithë repartit ynë kishim qeshur aq shumë deri

natën vonë, si nuk shkriu në atë çast dëbora që kisha nën këmbë”. Në krah të tij Nikollaqi, pranë e pranë, thuajse i kish zënë gjumi, pas një lodhje të gjatë. S’ të besohej se s’ do të ngriheshin kurrë më. Pak më tej të mbajtur për dore qenë shtrirë djali nga Seferaj, trimi Nexhip Çopa dhe shoku i tij Pëllumb Rrapo, që i plagosur nga orteku i parë, po transportohej drejt qytezës ushtarake. Mes atyre që e mbanin në sup, mes atyre që shpejtonin të shpëtonin shokun që dhe Nexhipi. Por orteku që pasoi nuk i kurseu të dy. Siç nuk kish kursyer dhe të mrekullueshmin Çlirim Pulaj, zëri i të cilit ende dukej se jehonte nga njëri shpat në tjetrin: “Forca shokë, kërkoni me guxim”. Kish mbyllur sytë përgjithmonë skënderbegasi simpatik, që pata takuar dikur në stacionin e trenit, i cili, edhe pse i vogël në moshë, arriti të më bindte me pjekurinë e durimin e një të rrituri që t’i hyja karrierës ushtarake, pasi ajo, kur punoje me nder, të bënte të respektuar si kur të ishte gjallë, ashtu edhe pas vdekjes. Xha Halil, si nuk t’u ça zemra, ty që t’u vranë shokët ndër duar gjatë luftës, kur dëgjove mandatën. Sa duron njeriu i shkretë, sa e fortë qenka zemra e prindërit. Ç’ bëre moj dëborë e mallkuar kështu! Si nuk t’u dhimbs shoku besnik Bujar Ago, si nuk të erdhi keq për Ilirin e sinqertë, për Qemal Likën e urtë, që pak para se të vdiste u ndau shokëve karamalet që kishte në xhep, sikur po martohej dhe jo po shkonte për të mos u kthyer kurrë më, për Pëllumbin që shkruante vjersha plot ndjenjë e që ndofta atë ditë do të shkruante edhe për dëborën që i doli tradhtare dhe e pabesë, si e preve moj dëborë në mes këngën e Besnik Shehut, jetën e Bilbil Pashait që e donte aq shumë dhe të Alekos që e donin aq shumë... Në këtë përleshje të pabarabartë, më çmenduritë e natyrës ku morën pjesë 203 vetë, shumica e të cilëve që farkëtuat në shkollën “Skënderbej”, bilanci përfundimtar që tepër tragjik. E parë me syrin e një ushtaraku me përvojë, është e kuptueshme se po të mungonte shpirti i pamposhtur luftarak dëmi do të që i pallogaritshëm.

..Këtu ngjet si në luftë, ku gjen zbatim sentenca e famshme se “Në tërheqje me panik, vdesin më tepër ushtarë se në betejë”. Nga ana tjetër, ndofta pikërisht për shkak të kësaj beteje, ne jemi mbledhur për t’i kujtuar me veneracion vëllezërit tanë dëshmorë, duke evokuar me këtë rast maksimën e Ovidit se “Kush do ta njihje Hektorin po të mos ndodhte fatkeqësia e Trojës?”

- ### VIKTIMAT E TRAGJEDISË SË FEKENIT:
- Komandant Dushan Shametaj
 - Student Qemal Lika
 - Student Besnik Shehu
 - Student Pëllumb Rrapo
 - Student Ilir Gramatiko
 - Student Nexhip Copa
 - Student Bujar Ago
 - Shef i Planëzimit Çlirim Pulaj
 - Pedagog Nikollaq Bero
 - Student Bilbil Pashaj
 - Student Aleko Gjoni

BALADA E TË NJËMBËDHJETËVE

(Kujtimet të dëshmorëve skënderbegas që u vranë nga orteku)

Agim Bajrami

Klith` një er` e ftohtë
Në rrëz` të Meçekut
Sikur do t`i zgjojë
Shokët posht` ortekut.

Netëve të gjata
Nën një hën` që qan
Njëmbëdhjet` balada
Shtrirë pran` e pran`.

Njëmbëdhjet` ballada
Gatuar me djej
Me zjarre nga vatra
Shkolla “Skënderbej”.

Ku u nisët bij
Atë dit` mortore
Qiellit ngjyrë gri
Me sy prej dëbore.

Flokshprishur nga era
Pabesi e shtegut
Me këmb` mbi humnera
Dhe grack` e ortekut.

Nën vështrim të malit
Mbështjellë prej murlanit
Se nuk din` të ndalen
Bijt` e partizanit.

Ballet mbushur yje
Poezi rinie
Dimri nëpër pyje
Shfryn mllef xhelozie.

Shfryn mllef xhelozie
Ndaj dhe ngrihka leq

Ah ju bij lirie
Ç`ju zu or` e keqe.

Në mal të Meçekut
Ç`tmerr ju panë sytë
Nën klithm` të ortekut
Sulmuan stuhitë.

Sulmuan stuhitë
Me kthetra mizore
Feken si s` t`u dhimbs
Nikua që na more.

Kur rrëmbeve Limon
Si se pyete zemrën
Mbi gjoks bashk` me yllin
Kish një vjersh` për nënën.

Po Qemalin bir
Me vështrim si dele
Sa kish ndar` për shokët
Një grusht karamele.

Karamele morti
Të verdha si ftua
Në mosh` të mëngjesit
I dhe vdekjen grua.

Krisma ngre kushtrimin
Gjaku skuq mbi tokë
Dyqind kryetrima
Për njëmbëdhjetë shokë.

Jeta sfidon vdekjen
Me sy dashurie
Sa zbulojn` Alekon
Një shok` tjetër bie.

Na iku Bujari
Me shpirt prej poeti
Në sup të Bilbilit
Çast` i mbram` e gjeti.

Komandant Dushani
Lis me tre kurora
Nuk i dilka xhani
Pa zënë bijt` nga dora.

Si t`i mbroj nga vdekja
Nga bora me gurë
E çfarë bën` më tepër
Vëllezërit Dioskurë?

Nën këng` elegjije
Prehet monopatii
Trimi Nexhip Çopa
Që u ngrit prej shtratit.

S`mund të rrinte brënda
E si mund të rrinte?
Kur vdekja tinzare
Shokët radhë i shtrinte.

Ilir Gramatiko
Pëllumbi, Besniku
Vdekjen vun` përpara
Pa dridhje qerpiku.

Mben` të gjith` atje
Me vështrim nga prita
T`i tregojn` mëngjesit
Shtigjet nga vjen drita.

Në mal të Meçekut
Në buz` të humnerës
Njëmbëdhjetë ballada
Frymojnë` prej pranverës.

Për martirët e Fekenit...
Muslim Pashaj

Ne ishim dje atje tek rrënjët e Shkollës “Skënderbej”. Përvjetori i shtatëdhjetë. Hodha sytë rrotull.

Thirra. Vrojtova. Nuk po i dalloja sytë e tyre, sytë e Bilbilit dhe Çlirimit. Njëri: vëlla dhe tjetri shok i bankës, i hartës e i koordinatës. Kisha atë çrregullimin tronditës që ta jep koha dhe hapësira, në bashkësinë rrotull, në raste të tilla. Pastaj ata u dukën dikund, mbi perden e rëndë të harresës, në të njëjtën kinema, ku dikur shfaqeshin filma të revolucionit, me të cilët ishin rritur të dy. Ngjanin të mërziut dhe gati të mos më flisnin. I ranë tërthor sallës, dhe nuk po njihnin moshën, që ishte thinjur, ndërkaq ata vinin nga një kohë tjetër, e ata nuk kishin dashur kurrë të thinjeshin e të plakeshin, ata donin të mbeteshin të rinj, ashtu duke u ngjitur. Pastaj erdhën dhe u mbështeten në murin anësor, sepse nuk kish vende se ku të uleshin, Çlirimi në krahë të Kiço Mustaqit dhe Bilbili në krahun tim. Ne filluam të flisnim fjalë të thyera, se befasia na kapi në çast. Mirëpo të dy, si në të njëjtën gojë bënë shenjë të mos ndiheshim, sepse ata e kishin ndjekur jo vetëm Ortekun që i mori por edhe ortekun që përfshiu një shoqëri të tërë që vijon ende të jetë e çoroditur. Po dëgjonin edhe ca fjalime nga këta të mbeturit e sotëm. Askush rrotull nuk po i njihje. Shpirti është gjithnjë i ri, edhe pse i vjen edhe atij fundi. Po ama është i ri. Skënderbegasit e kishin lënë shpirtin e tyre diku në përfytyrime ëndrrash. “Më mirë që ikëm të rinj”, thanë. Pastaj u përthithën nga fryma dhe ne e kuptuam se ata kishin një pjesë nga fryma që bartim ne skënderbegasit, e gjallë. Dikush ma solli lajmin se në çdo përvjetor Vladimir Pulaj, i vëllai i Çlirimit në krahë të një saksie me lule del për të pirë një kafë me Çlirimin.

- Po ti, ku po shkon? - më tha Kiço Mustaqi, komandanti ynë i togës.

- Po shkoj në vendlindjen e Bilbilit, atje ku është një gur të cilit ia thonë emrin “Guri i Ullirit të Burimit”

POEZI PËR ÇLIRIM PULAJN

Ja, nga dritarja që u hap,
Del Skënderbegasi përbri,
Çlirimi iku, erdhi prapë,
Po aq i bukur dhe i ri.

Në këtë fragment` që sjell orteku,
Apo dëbora dhe acari,
Çlirim i Pulajve, tek shtegu,
Prapë skënderbegas, si i pari.

Në sup, i rëndë, një mal i ngritur,
Çlirim, sa gjëra që kanë rrjedhur!
Më mirë që ike pa e ditur,
Se do të rrudheshe patjetër.

Tani ti vjen, në festa, mbresa,
Se vet je mbresa më e thellë.
Çlirim i Pulajve, kujtesa,
E ka një strehë që rri mbështjellë.

Ajo që ne s’e themi dot,
Më mirë në ortek të ishim matur,
Se sa të grindet, jetë e mot,
Nga ankthi që godet i çartur.

Po gjersa diellin ti e deshe,
Bashkë me Bilbilin, tim vëlla,
S’menduat kurrë se iku shpresa,
Se ikin ëndrrat e mëdha.

Ne bashkë e bëmë dikur një hartë,

Diku mbi malin e Ivanit,
Aty ti rron si koordinatë,
Që nuk ndryshon përmes tufanit.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Natyra është arti i Zotit, bekimi që na vjen prej Tij, frymëzim i krijimit të genies njerëzore”.

Gjithçka rrotullohet rreth natyrës, sa njeriu ka lidhur një kordon aq të veçantë me të që po të shkatërrohej kjo lidhje, prishja e ekuilibrit ushqimor do ishte pasoja kryesore.

Pafajësia që na fali nëna natyrë në lindje ka ndryshuar me kalimin e kohës, mirësia në ato shpirta të brishtë ka evoluar në dashakeqësi, ku të mos mjaftonte dëmi që i shkakton të tjerëve, po përpigjet të shkatërrojë ambientin që çdo ditë e më shumë bëhet pjesë e vetë karakterit dhe shpirtit tij.

Njeriu po përpigjet të tërheqë gjithçka që i nevojitet për mbijetesë prej saj. Ajri që marrim frymë, uji që pimë, ushqimi që hamë dhe mijëra artikuj që përdoren çdo ditë të gjitha të ardhura nga natyra. Megjithatë çuditërisht njeriu mban një qëndrim armiqësor ndaj natyrës. ‘Pushimi i natyrës’ është shprehja që mund të përcaktojë më mirë veprimtarinë njerëzore në mjedisin rrethues. Njeriu po e trajton natyrën si pronë private duke ia humbur vlerat. Ne po e shkatërrojmë këtë mjedis, po e prishim këtë atmosferë. Miliona fabrika të mëdha dhe të vogla janë ngritur në tërë rruzullin tokësor. Numri i automjeteve po rritet dita ditës. Ky tym është kthyer në sëmundje, sidomos në qytetet e mëdha. Harrojmë se ajri është nevoja e menjëhershme dhe e rregullt e njeriut. Dhe nuk ngulet me kaq, njerëzit po presin edhe pastrueset e ajrit - pemët.

Natyrë është pjesë e integraleve tona dhe ne po e plaçkitim këtë thesar çdo ditë e më shumë. Kjo lule gjigande jete po vyshket çdo ditë e më shumë dhe po venitet nën hijeshinë e saj, pamundësisht të fitojë pak impenjim nga këto genie humane që pabesisht e godasin kur u jepet mundësia, duke shkatërruar jo vetëm jetën e tyre, por po i hyjnë në hak brezave pasardhës.

Natyrë është vetë jeta, gjëja më e çmueshme e jona sa as finesa e njeriut nuk do të dëshmonte një shpikje më të bukur, më të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë sa natyra. Ajo është më e shtrenjtë se tërë pasuritë minerale të tokës së bashku, më e bukur se diamanti, sa vetë e keqja dorëzohet përpara saj dhe më humane se vetë njeriu. Kujdesi ndaj natyrës është detyrim moral.

Ngjyrat janë buzëqeshja e natyrës, natyra është buzëqeshja jonë.

Edhe pse e dimë që lidhja me natyrën është e njëjtë si lidhja e nënës me fëmijën, sërish vazhdojmë të ‘investojmë’ në shkatërrimin e saj.

A jemi vetë ne humanët që po prishim balancat e “nënës natyrë”? Shkak-pasoja!?

Numri në rritje i popullsisë në mbarë globin ka bërë që të shfrytëzohen sa më shumë burimet natyrore dhe shfrytëzimin sa më të madh të tokës. Prerja e pyjeve, ndotja nga industria apo mbetje të tjera mbeten një shqetësim që bëhet çdo ditë e më i madh.

Nga ana tjetër, ngrohja globale,

Ngjyrat janë buzëqeshja e natyrës, natyra është buzëqeshja jonë



mbetet një problem tjetër shumë i madh, ku ndryshimet e shumta klimaterike mund të shkaktojnë shfaqjen e shumë specieve, të cilat mund të prishin ekuilibrin e jetës në tokë.

- **Në vitin 2008 Cikloni Nargis** shkaktoi katastrofën më të madhe të historisë të Myanmar (Burma, e cila njihet si Republika e Bashkuar e Myanmar, në Jug-Lindje të Azisë), duke vrarë rreth 146 000 njerëz, shkatërruar më shumë se 700 mijë shtëpi, duke shkatërruar pjesën më të madhe të tokave pjellore, dhe me dëme materiale rreth 10 miliardë \$. Kjo katastrofë, e cilësuar si e katërta më e madhe e shekullit XXI, nuk ishte e siguruar, për shkak të vendndodhjes gjeografike dhe izolimit të këtij rajoni.

- **Tërmeti Gujarat** tronditi tokën më 16 Janar 2001 dhe pikërisht në ditën e Republikës Indiane. Lëkundja rreth 7.7 e shkallës Richter zgjati pothuajse 2 minuta. Tërmeti vrau rreth 2 000 njerëz, plagosi 167 000 të tjerë dhe shkatërroi rreth 400 000 shtëpi. Ky rast është i ngjashëm me Ciklonin Nargis, nga pikëpamja e sigurimit të katastrofave.

- **Vala e nxehtë e Europës 2003** është vera më e nxehtë që Europa ka përjetuar ndonjëherë në 500 vitet e fundit të njerëzimit. Shtetet që u prekën ishin Franca, Gjermania, Spanja, Portugalia, Holanda, Italia, Zvicra, Britania e Madhe dhe Irlanda. Në të gjithë Europën humbën jetën rreth 35 mijë persona, ndërsa shteti që u godit më shumë ishte Franca, me rreth 14 802 të vdekur nga i nxehti, pasi në disa qytete të saj temperaturat arritën rekordin e shënuar ndonjëherë në historinë e njerëzimit në tokë, me 99 gradë celsius, ndërsa Gjermania arriti shifrën rekord të temperaturës, mbi 100 gradë celsius në qytetin e Fahrenheit, më datë 10 gusht 2003. Dëmet ishin katastrofale, duke marrë parasysh se sa jetë njerëzish humbën, ndërsa dëmet materiale në pyje, ferma dhe bagëti u numëruan 15 miliardë Dollarë.

- **Tërmeti Sichuan**, i 12 majit të vitit 2008, është konsideruar si tërmeti me më shumë vdekje në

historinë e Kinës, duke vrarë 69 197 persona, ndërsa rreth 11 milionë të tjerë mbetën pa strehë. Lëkundja kishte një shkallë goditje 8.0 dhe u regjistruan nga 64 në 104 dridhje të mëtejshme në 72 orët në vazhdim. Grupi më i madh i viktimave u përkiste studentëve, me rreth 20 mijë të vdekur, në rreth 7 mijë shkolla të shkatërruara. Dëmtime të mëdha pësoi dhe agrikultura si dhe me miliona bagëti ngordhën dhe 12.5 milionë kafshë gjithashtu u numëruan të ngordhura. 2.5 milionë shtëpi u shkatërruan totalisht ndërsa miliona të tjera pësuan dëmtime të pjesshme.

- **Tërmeti Kshmir**, në rajonin ndërmjet Indisë dhe Pakistanit, në vitin 2005 me magnitudë 7.6 të shkallës Richter, ishte i njëjtë me tërmetin e vitit 1906 në San Francisko. Rreth 86 mijë persona humbën jetën në Pakistan dhe 1 350 të tjerë në territorin e Indisë. Mbi 4 milionë të tjerë mbetën pa shtëpi, rreth 10 mijë shkolla u shkatërruan së bashku me qindra-mijëra ndërtesa të tjera, përfshirë edhe zyra të qeverisë. As spitalet, urat dhe rrugët nuk i shpëtuan shkatërrimit nga tërmeti

- **Fatkeqësia më e shtrenjtë natyrore në njëzet vjetët e kaluar ka qenë tërmeti “Tohoku” në Japoni**, më 11 mars 2011, i cili shkaktoi cunamin shkatërrues, ku më se 20 mijë njerëz humbën jetën, si dhe shkaktoi avari në centralin nuklear “Fukushima”. Banka Botërore i përlogariti dëmet në 234 miliardë \$, duke u bërë katastrofa natyrore më e kushtueshme në historinë e botës, nga të cilat 40 miliardë u paguan nga industria e sigurimeve: 1.5 miliardë dollarë u paguan nga Munich Re, 516 milionë Paundë u paguan nga gjigandi britanik i sigurimeve, “Lloyd’s of London”.

- Një nga fatkeqësitë më të kushtueshme natyrore, renditet edhe **tërmeti në Japoni, më 17 janar 1995**, kur në rajonin e qytetit Kobe humbën jetën 6 000 persona dhe u plagosën 30 mijë të tjerë. 150 mijë ndërtesa u shkatërruan plotësisht dhe mbi 300 mijë persona mbetën pa strehë. U shkakua dëm material në

vlerë prej 100 miliardë Dollarësh.

- **Uragani “Sandy”**, i cili u mori jetën më shumë se 60 personave në SHBA më 2012, sipas vlerësimeve shkaktoi dëme midis 30 dhe 50 miliardë Dollarësh. Për shkak të rrezikut nga katastrofa, janë evakuuar më shumë se 400 000 persona dhe është ndërprerë aktiviteti ekonomik në pjesët lindore të SHBA-së.

- **Katastrofa e katërt më e kushtueshme natyrore në çerekun e fundit të shekullit në SHBA ka qenë tërmeti “Northridge”**, i cili përfshiu Los Angeles, më 17 janar 1994, në të cilin humbën jetën 60 njerëz, ndërkaq 10 000 të tjerë u lënduan. Përmasat e dëmit material vlerësohen në rreth 44 miliardë Dollarë.

- **Tërmeti shkatërrimtar**, i cili nuk mbahej në mend deri në atë kohë **në Kili**, më 27 shkurt 2010, ka

shkakuar dëm material më shumë se 30 miliardë Dollarësh.

- **Dalja nga shtrati e lumit Yangtze**, në vitin 1988, ka shkakuar përmbytje që nuk mbahen në mend në tërë Kinën, në të cilat kanë humbur jetën më shumë se 3 600 persona. Në total nga kjo përmbytje, e dyta për nga pasojat e rënda në Kinë që prej 150 vitesh, u prekën 240 milionë njerëz, u shkatërruan totalisht 5 milionë shtëpi dhe u dëmtuan pjesërisht 12 milionë të tjera. Dëmet e shkaktuara nga kjo katastrofë u përlogariten në 20 miliardë Dollarë.

- **Fatkeqësia më e madhe natyrore në Francë ka ngjarë me rastin e shtrëngatave, të cilat në dhjetor 1999** goditën njëkohësisht edhe Zvicrën, Danimarkën dhe Gjermaninë. Me atë rast vetëm në Francë kanë humbur jetën 90 persona dhe është shkakuar dëmi prej 13 miliardë Eurosh.

- **Tërmeti me magnitudë prej 7.8 ballësh goditi Turqinë** dhe Sirinë mëngjesin e së hënës, së datës 6 shkurt 2023, ka të ngjarë të jetë një nga më vdekjeprurësit këtë dekadë, me një thyerje prej më shumë se 100 kilometrash (62 milje) midis blloqeve të Anadollit dhe Arabisë. Mijëra persona kanë vdekur dhe mijëra të tjerë janë lënduar. Epiqendra e tërmetit ishte afër qytetit turk Gaziantep. Mbi 16 mijë persona kanë humbur jetën si pasojë e tërmeteve të fuqishme të 6 shkurtit në Turqi dhe Siri. Në Turqi, mbi 60 000 njerëz janë plagosur dhe më shumë se 12 873 kanë humbur jetën, sipas agjencisë së menaxhimit



vrarë 560 njerëz dhe ka shkakuar dëm prej 30 miliardë Dollarësh, për shkak të rrezimit të ndërtesave dhe urave, ndërprerjes së rrymës elektrike dhe të linjave telefonike. Dëmet e shkaktuara u përlogariten në rreth 30 miliardë Dollarë.

- **Uragani “Ike”** i cili goditi SHBA-të, Kubën dhe Haitin, filloi më 12 shtator 2008 dhe përlogaritet të ketë vrarë 80 persona në territorin e Amerikës Veriore si dhe ka

të fatkeqësive. Në Siri janë raportuar mbi 3 162 viktima.

Shkatërrimi i natyrës është një shqetësim që po ngrihet çdo ditë e më shumë nga njerëz në të gjithë botën, por ata harrojnë se një nga ata që shkakton shkatërrimin më të madh të saj është vetë njeriu. Kjo katastrofa natyrore e kanë bazën e tyre të interpretimit shkencor, por vëmendja dhe puna jonë është të ndërgjegjësohemi në vënie e ekuilibrave mes nesh dhe burimeve natyrore, tanimë si “specie në zhdukje”.

Femrat, janë një forcë e fuqishme, ato mund të ndryshojnë historinë, të mobilizojnë ushtritë dhe të fillojnë revolucionet


Rreshter Entela Troqe, pjesë e Forcave të Armatosura, është nga ato vajza që çdo ditë e kalon me makinat e forcës tokësore, në një pozicion që gjithmonë është konsideruar si një punë burrash por që ajo e ka me shumë pasion, gjetjen e defekteve të makinave të FA-së dhe rregullimin e tyre. Entela është bërë pjesë e promovimit të Ministrisë së Mbrojtjes për shkak të detyrës specifike.

Ajo është rreshter, me detyrë zëvendës komandante e togës së mirëmbajtjes dhe drejtuese e grupit të shërbimeve në batalionin e Forcës Tokësore. Është pjesë e FA-së prej gati 20 vjetësh. Dëshira për të mbajtur këtë uniformë vjen që nga fëmijëria sepse babai i saj ka qenë ushtarak. Detyra e saj konsiston në evidentimin e problematikave të teknikës së transportit.

Është një punë që e bën me shumë pasion, pavarësisht paragjykimit se në përgjithësi nuk bëhet nga gratë e vajzat.

Vetë Entela shprehet se nuk ka bërë kurse teknike që nga koha kur u pajis me lejen e drejtimit. Por kur kanë ardhur disa herë ekipet amerikane në forcën tokësore, ka qenë pjesë e trajnimeve për teknikat e reja.

Asnjëherë gratë dhe vajzat, pjesë e Forcave të Armatosura, nuk i kanë parë vështirësitë si të pamundura, përkundrazi, kanë ecur përkrahë kolegëve të tyre burra pa u ndier inferiore, në realizimin e çdo detyre të ngarkuar me hijeshi dhe dinjitet.



Distria Krasniqi, më e mira në botë, fiton medalje të artë në "Grand Slam Paris 2023"

Distria Krasniqi, tashmë pjesë e ekipit të sportistëve elitare të FA-së, na bëri sërish krenarë si komb me rezultatin e saj fantastik.

Distria Krasniqi ka fituar medaljen e artë në "Grand Slam Paris 2023", pasi në finale mposhti xhudisten hungareze, Reka Pupp.

Për Distrian ky ishte "Grand Slami" numër katër i fituar në Paris.

Ndërkaq, në rrugëtimin e saj deri tek medalja e artë, Distria raundin e parë e kaloi pa luftë, kurse në të dytin mposhti spanjollen, Marina Diez Castello.

Krasniqi e vazhdoi edhe më tej formën fantastike, ku në çerekfinale fitoi kundër mongoles Sosorbaram Lkhagvasuren, kurse në gjysmëfinale mposhti francezen, Amandine Buchard.

Në finale, Distria Krasniqi mposhti xhudisten nga Hungaria, Reka Pupp, duke fituar medaljen e artë në këtë turne.

Kjo është forca e femrës shqiptare!

Aristokracia e mozaikëve të Durrësit

Gjatë shekullit të kaluar, në Durrës janë zbuluar mjaft mozaikë, me “moshë” të ndryshme, por edhe me cilësi, subjekte dhe vendndodhje të veçanta, që pasqyrojnë zhvillimin ekonomik dhe kulturor të qytetit.

Mozaikët janë monumentet arkeologjike që njihen më pak në Durrës. Qyteti më i vjetër i bregut lindor të Adriatikut, që vazhdon të mbijetojë pas 3 mijë vitesh jetë qytetare, ofron për vizitorët amfiteatrin antik, mure dhe fortesa mesjetare me forma të ndryshme, termat (banjat) romake dhe forumin rrethor, që të gjithë monumente madhështore.

Pamjet e tyre tërheqëse shihen shpesh në suvenire apo skenografi spektaklesh. Por, ndërsa numri i turistëve të huaj që kërkojnë të vizitojnë rrënojat qindraveçare rritet vazhdimisht, fati i mozaikëve ka qenë i ndryshëm.

100 vjet zbulime

“Bukuroshja e Durrësit”, mozaiku me Kalë Deti, ai i Rozetës apo mozaiku i Bazilikës së Arapajt, janë vetëm disa nga veprat më të shquara, që i japin një dimension mjaft të rëndësishëm antikitetit dhe mesjetës në qytetin bregdetar.

Vetë mozaikët janë në të njëjtën kohë dëshmi e gjenisë krijuese të artistëve anonimë, të cilët kanë lënë pas vlera të papërsëritshme.

Zbulimi i parë në këtë fushë i përket vitit 1916, kur një grup ushtarakësh austriakë, mes të cilëve edhe arkeologu Camillo Prashnicher, zbuluan gjatë hapjes së një transheje 150 metra larg qendrës së sotme një shtresë mozaiku, e cila u quajt një “kryevepër figurative e artit”. Por mozaiku i mrekullueshëm me emrin “Bukuroshja e Durrësit” është bërë i njohur në të gjithë botën shkencore vetëm në vitin 1959.

Këmbëngulja e arkeologut të shquar Vangjel Toçi risolli në dritë 50 vjet më parë një nga veprat më të shquara të lashtësisë. Toçi ndoqi me kujdes të dhënat e shkruara nga arkeologët austriakë në fillimin e shekullit të 20-të, lidhur me praninë e mozaikut në një nga lagjet qendrore të Durrësit. Mozaiku i shekullit të 4-3 para erës sonë ka formë eliptike me diametrin e madh 5.1 metra dhe zë një sipërfaqe afro 9 metra katrorë. Në qendër të mozaikut është figura e një gruaje të re dhe të bukur mes një peizazhi plot kërcel lulësh, gonxhesh dhe petalesh.

Mozaiku është mbiquajtur “Bukuroshja e Durrësit”, një emër metaforik në nderim të grave të qytetit të lashtë, por edhe të mjeshtrave që e krijuan atë. Ky mozaik ka zbuluar për një kohë të gjatë një banjë luksoze private të qytetit antik.

Sfondi i dizajnit

Dizajni që rrethon figurën femërore është unik në lidhje me përbërjen e tij dhe sfondi i mozaikut është me ngjyrë të zeze. Karakterizohet nga një lirizëm i fortë i formave, i dukshëm në vazhdimësinë e linjave kaçurrela, dizajn spontanisht harmonik dhe me



një shpërndarje fluide të elementeve. Figura e femrës është e rrethuar nga lule të llojeve të ndryshme, të tilla si zymbyl, zambak, dhe lulëlakër, si dhe elementë të tjerë me lule të tilla si kërcell, sytha dhe petale.

Teknika

Mozaiku është punuar duke përdorur teknikën opus vermiculatum, kështu që një skicë e lehtë është tërhequr rreth formave duke përdorur teknikën tesserae, e cila është e kontrastuar nga sfondi i zi i errët. Guralecët e lumenjve me ngjyra të ndryshme janë mbërthyer me një mjeshteri të shkëlqyeshme. Efekti plastik i portretit arrihet duke përdorur disa nuanca të guralecëve të bardhë, të pozicionuar në model me një aftësi të jashtëzakonshme. Ndërsa linjat e zeza përdoren vetëm për modelimin e tipareve kryesore të portretit.

Ekzistojnë të paktën dy teori në lidhje me temën e portretizuar në mozaik. Sipas historianit dhe arkeologut Moikom Zeqo, gruaja e përfaqësuar në mozaik është e njëjtë me atë të pikturuar

në arketipat e amforave në Puglia dhe pjesë të tjera të Italisë Jugore, me figura të kuqe të epokës helenistike. Sipas tij, ‘Bukuroshja e Durrësit’ përfaqëson perëndeshën e Kretës, Eileithya, e cila ishte perëndeshë e lindjes dhe mamisë, duke ndihmuar në ofrimin e foshnjave të shëndosha. Sidoqoftë, arkeologu Afrim Hoti sugjeron se portreti i gruas është ndoshta vajza Aura, një shoqëruese e perëndeshës Artemis në gjueti.

Koka e gruas është në shkallë të gjerë, me fytyrë dhe faqe të gjera. Ajo ka një qafë të gjatë të drejtë dhe koka e saj është kthyer paksa në anën e majtë, duke krijuar një portret tre të katërtat. Imazhi i saj shfaqet i qetë dhe paqësor dhe pamja e saj është ëndërrimtare, gati melankolike.

Shifra përshkruhet me buzë të lakuara të kuqe me shkëlqim. Plasticiteti i përpunuar me përpikëri i buzëve, zgjimi i formës dhe pozicioni i tyre pak i hapur, i japin asaj një fizionomi jashtëzakonisht femërore. Një guralec i vogël i verdhë dhe i kuqe i vetëm në bebëzën e syrit të saj krijon një pamje

vërtet të rrallë në figurën e gruas. Kurora e flokëve të saj të kuqërremtë është përshkruar veçanërisht mirë dhe dallohen mjaft mirë nga sfondi i zi nëpërmjet përdorimit të një të bardhe siluetë. Efekti plastik i figurës femërore të mozaikut në tërësinë e tij, paraqet një vepër artizanale artistike shumë të zhvilluar për kohën.

Në vitin 2004, Banka e Shqipërisë lëshoi një monedhë që shënonte lashtësinë shqiptare, duke përshkruar “Bukuroshen e Durrësit” dhe elementët dekorativë të saj në të dy anët e monedhës. Kjo është një monedhë metalike e bardhë e dhëmbëzuar me një vlerë fytyre 50 lekë, 24.25 milimetra (0.955 in) në diametër dhe që peshon 5.50 gram, të punuara nga një aliazh prej 75 pjesësh bakri dhe 25 nikel.

Pamja e monedhës tregon Bukuroshen e mozaikut të Durrësit, e rrethuar me harqe dhe motive lulësh të stilizuara nga mozaiku. Në harkun e monedhës ka disa motive dekorative, siç janë qarqet simetrike të periudhës ilire. Pjesa e prapme e monedhës mban një

krijim dekorativ në qendër të saj, i rrethuar me motive lulësh të marra nga mozaiku. Kjo shifër shoqërohet akoma me qarqe deri në harkun e monedhës, poshtë së cilës gjendet mbishkrimi

“SHQIPËRI-ALBANIA 2004”.

Nën dhe apo mbi dhe?!

Gjatë 60 viteve të fundit, në Durrës janë zbuluar edhe mozaikë të tjerë me përmasa të ndryshme. Në kapelën mesjetare të ndërtuar pranë njëres nga galeritë e Amfiteatrit antik të Durrësit, ndodhet i vetmi mozaik mural që është zbuluar në vendin tonë. Në vitin 1968 gjatë ekspeditave për zbulimin e monumentit më të madh të vendit tonë, arkeologët ndeshën tre faqet murale me figurat e shenjtorëve.

Megjithëse ende nuk ka një qëndrim të përcaktuar të specialistëve mbi datimin dhe subjektin e mozaikut, në të shihen qartë portretet e Shën Sofisë dhe Irinit si dhe Zeusit.

Mozaikët e Durrësit janë tregues i mirëqenies ekonomike të një shtrese qytetare, e cila i ka lejuar vetes të jetojë mirë, pavarësisht nga kohët që kalonte bota pranë tij. Qyteti vazhdon të ndërtohet edhe sot në të njëjtin vend ku është ngritur dhe ringritur për shekuj me radhë dhe shpesh herë themelet e godinave të reja janë bërë dëshmitare të së kaluarës.

Tetë vjet më parë, vetëm 200 metra në veri të ish-merkatos, punëtorët e një firme ndërtuese zbuluan rrënojat e një ndërtese të shek. I pas Krishtit dhe një mozaik me një sipërfaqe 9 metër katrorë. Është një mozaik me përmasa 3 metër me 3 metër, ku dallohet si të ishte ndërtuar sot një lule 12 petalesh brenda një rrethi të kuq. Zbulimi nuk i çuditi arkeologët zona njëhej si lagje patricësh aristokratë, njëllonj me territorin ku u zbulua “Bukuroshja 2300-vjeçare”. Që në vitin 1947, vetëm 50 metra larg Rozetës shumëngjyrëshe, ishte zbuluar mozaiku i Hipokamit, i njohur si mozaiku me Kalë Deti. Deri në vitin 1989 mozaiku që ndodhet në thellësinë 4 metra është hapur edhe dy herë të tjera, por mungesa e teknikave për ta spostuar drejt muzeut të ri arkeologjik i detyroi arkeologët që ta mbyllnin përsëri atë.

E ndërsa pallati 8-katësh mbi Rozetën u ndërtua me marrëveshjen që monumenti të ishte i vizitueshëm, mozaiku me Kalë Deti vazhdon të qëndrojë në tokë. “Ndoshta më mirë, shprehen arkeologët, të cilët shtojnë se fatmirësisht figura e madhe bardhë e zi qëndron nën kryqëzimin e rrugës, pra aty ku nuk do të ndërtohet”.

Madje, është shumë më i sigurt nën tokë, ku agjentët atmosferikë nuk mund ta shkatërrojnë siç po ndodh me muralen e kishëzës së amfiteatrit”.

Mozaiku qëndron i mbuluar prej kohësh me një shtresë cellofoni ku rëndon rëra e lagur prej shirave. Figurat njerëzore, ato të kafshëve si dhe lulet shumëngjyrëshe të mozaikut, janë zënë si në çark dhe mbeten me shpresën e rikthimit përballë shikuesve.



Fshehur në pamje të qartë: Përmirësimi i reagimeve ligjore për viktimat 'e padukshme' të femicidit

Javët e fundit, vrasjet e një gruaje apo vajze për shkak të gjinisë (femicid) në disa shtete anëtare të BE-së tregojnë urgjencën për t'iu përgjigjur më mirë këtij fenomeni.

Sot EIGE publikon raportin "Përmirësimi i reagimeve ligjore për të luftuar femicidin" në Bashkimin Evropian: Perspektiva nga viktimat dhe profesionistët.

Raporti vijon paketën e EIGE për të ndihmuar vendet e BE-së të mbledhin të dhëna të forta për të klasifikuar dhe matur femicidin.

Vargu i rasteve të femicideve në vitin 2021 i vë të drejtat e viktimave në fokus.

Sipas UN Women, 45 000 gra dhe vajza në mbarë botën u vranë nga partnerët e tyre intim ose anëtarë të tjerë të familjes. Kjo do të thotë se, mesatarisht, më shumë se pesë gra ose vajza vriten çdo orë nga dikush në familjen e tyre. Kjo duhet të ndryshojë.

Kuadri ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i detyron shtetet të ndjekin parimin e kujdesit të duhur kur të formësojnë përgjigjet ndaj dhunës ndaj grave. Kjo do të thotë se ata duhet të parandalojnë, hetojnë dhe ndëshkojnë të gjitha aktet e dhunës ndaj grave, si dhe të mbrojnë viktimat dhe të ofrojnë dëmshpërblime gjithëpërfshirëse për të ndihmuar në shërimin e traumës së tyre.

Por ne gjithashtu duhet të pranojmë se viktimat e femicideve shkojnë përtej një personi.

Anëtarët e familjeve të grave të vrara, fëmijët, prindërit dhe anëtarët e tjerë të ngushtë të familjes, janë të fshehur në pamje të qartë. Megjithatë, përvojat e tyre me zbatimin e ligjit dhe sektorin e drejtësisë janë shpesh të dhimbshme.

Kjo është për shkak të informacionit të pamjaftueshëm për të drejtat e tyre, mungesës së qasjes së orientuar drejt viktimave, të informuar për traumat dhe mungesës së njohjes ligjore të rolit të tyre gjatë proceseve gjyqësore duke ndikuar negativisht në aksesin e tyre në drejtësi.

Në këtë raport të ri, EIGE u jep një zë si profesionistëve ligjorë ashtu

Sipas UN Women, 45 000 gra dhe vajza në mbarë botën u vranë nga partnerët e tyre intim ose anëtarë të tjerë të familjes. Kjo do të thotë se, mesatarisht, më shumë se pesë gra ose vajza vriten çdo orë nga dikush në familjen e tyre. Kjo duhet të ndryshojë.

edhe viktimave që flasin për përvojat e tyre se si është të përballesh me pasojat e femicideve. Intervistat ofrojnë një pasqyrë autentike të të metave të sistemeve ligjore, siç janë masat e pamjaftueshme të menjëhershme pas një raportimi të dhunës.

"Kur thashë publikisht se mbesa kishte bërë shumë ankesa, të cilat nuk u gjetën, mund të kërkonin për të më kundërshtuar, për të verifikuar. Por nuk kishte asgjë. Asnjë hetim. Në momentin e gjyqimit, megjithatë, ata thanë se kishin gjetur një ankesë, si rastësisht. Por ky djalë nuk ishte thirrur. ... Pse e trajnojmë policinë për të ndërhyrë dhe ata largohen pa bërë asgjë? Dhe ne habitemi që 8 muaj më vonë gjejmë mbesën time në një arkivol.

(Familjar i viktimës, Francë)"
Raportimi i pandjeshëm i medias gjithashtu mund të shtojë traumën e përjetuar nga viktimat.

"Në gjykatë, nga këndvështrimi im, këto takime duhet të bëhen me dyer të mbyllura në raste të tilla sepse ka vuajtje të madhe. Në sallat e gjyqit njerëzit janë si në një sallë teatri. Përveç faktit që dhimbja është e madhe, është edhe stresi që dikush po i shikon, për të mos folur për shtypin. E dija që ishte shtypi. Bëhet i ditur çdo rast i këtij lloji, është i njëjtë kudo... shtypi lokal. Kishte dy mbledhje publike në gjyq. Viktimat qanin çdo herë.

(Përfaqësues ligjor i viktimës, Rumania)"

Raporti i EIGE vë në dukje gjithashtu dukshmërinë e kufizuar të femicidit në politikat kombëtare dhe thekson përfitimet e mundshme të njohjes së femicidit si një vepër penale më vete:

"Sepse ajo që nuk ekziston, as nuk diskutohet. As me autoritetet hetuese, as me procedurat hetimore dhe as me gjyqtarët.

(Profesionist, këshilltar, Gjermani)"
Për të ndryshuar mënyrën se si ne e perceptojmë femicidin, legjislati duhet të japë shembull.

Shtetet Anëtare mund të përmirësojnë procedurat ligjore dhe të zvogëlojnë numrin e viktimave duke:

- Sigurimi i një reagimi të koordinuar ndaj femicideve. Shtetet anëtare duhet të kenë strategji kombëtare për dhunën ndaj grave dhe të zhvillojnë masa specifike për parandalimin e femicideve.

- Forcimi i përgjigjeve ligjore. Femicidi duhet parë si vepër penale më vete. Kjo kërkon miratimin e protokolleve hetimore për oficerët e zbatimit të ligjit dhe udhëzimeve për prokurorët.

- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave për rastet e femicideve. Të dhënat janë një mjet vendimtar për të kapur jo vetëm shkallën e fenomenit, por edhe për hartimin dhe monitorimin e masave parandaluese dhe reagimi.

- Sigurimi i aksesit të plotë në kompensim dhe dëmshpërblim. Kjo përfshin të drejtën e viktimës për para të dhëna nga shteti kur dhunuesi nuk mund ta bëjë këtë, dhe dëmshpërblim të tillë si mbështetja e viktimave për të shëruar traumën e tyre me këshillim.

- Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të viktimës. Sigurohuni që të paktën standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të përcaktuara nga direktiva për të drejtat e viktimave të njihen plotësisht në Shtetet Anëtare.

Mungesa e antibiotikëve në BE, përditësimi i EMA-s

Grupi Drejtues Ekzekutiv i EMA-s për Mungesat dhe Sigurinë e Produkteve Medicinale (MSSG) u takua të enjten për të diskutuar përparimin e bërë dhe për të rënë dakord mbi hapat e ardhshëm në përgjigjen e koordinuar ndaj mungesës së vazhdueshme të barnave antibiotike që përmbajnë amoxicilinë (vetëm dhe në kombinim me acid klavulanik) në BE. MSSG përbëhet nga përfaqësues nga EMA, Komisioni Evropian dhe Drejtuesit e Agjencive të Barnave (HMA).

Një rritje e kohëve të fundit e infeksioneve të frymëmarrjes ka nxitur një rritje të kërkesës për amoxicilinë, e cila e kombinuar me çështje të tjera, duke përfshirë vonesat e prodhimit dhe sfidat e kapacitetit të prodhimit, çoi në mungesa që prekin shumicën e Shteteve Anëtare.

MSSG dhe grupi i saj i punës, grupi i punës SPOC, kanë monitoruar nga afër situatën që nga nëntori 2022 dhe janë angazhuar me aktorët kryesorë në zinxhirin e furnizimit të amoxicilinës për të ndërmarrë masa të mundshme zbutëse. Të dhënat ofrohen nga Shtetet Anëtare nëpërmjet SPOC WP, nga shoqatat e industrisë, si dhe nga palët e interesuara, duke lejuar një kuptim të qartë dhe të përditësuar të situatës aktuale.

Si rezultat i këtyre veprimeve, MSSG vuri në dukje disa përparime që nga fillimi i monitorimit dhe përpjekjeve zbutëse:

Bazuar në raportet e ofruara nga Shtetet Anëtare përmes SPOC WP, një trend pozitiv është vërejtur në një sërë shtetesh anëtare, ndërkohë që pranohet se disa të tjerë ende vazhdojnë të kenë një disponueshmëri të reduktuar të këtyre dhe antibiotikëve të tjerë.

Rregullatorët e BE-së janë takuar me palët kryesore të përfshira në zinxhirin e furnizimit të amoxicilinës për të ofruar mbështetje rregullatore në mënyrë që të rritet kapaciteti i prodhimit (p.sh. përmes procedurave të shpejta për të zbatuar ndryshimet në burimet alternative të lëndëve të para, vendet e prodhimit, materialet e paketimit...) dhe rishikuan mundësinë për të rritur ofertën për të përmbushur nevojat imediate të Shteteve Anëtare.



EMA ka marrë reagime pozitive nga prodhuesit kryesorë dhe oferta pritet të rritet (për shembull, përmes furnizimit shtesë dhe rritjes së kapacitetit të prodhimit) në javët dhe muajt e ardhshëm.

Duke përdorur disa fleksibilitete rregullatore, të tilla si furnizimi i jashtëzakonshëm i disa ilaçeve që mund të mos autorizohen në një Shtet Anëtar të caktuar të BE-së, ose përjashtime të plota ose të pjesshme nga kërkesat e caktuara të etiketimit dhe paketimit për barnat, shumë autoritete kombëtare kompetente kanë arritur të zbusin disa mungesa.

Shtetet Anëtare të BE-së presin që kulmi i infeksioneve të fillojë të ulet së shpejti, gjë që pritet të ulë kërkesën aktualisht në rritje për antibiotikë. Pacientëve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor u kujtohet se në shumicën e rasteve alternativat janë të disponueshme nëse një ilaç i caktuar ka mungesë.

MSSG diskutoi gjithashtu mungesat aktuale të amoxicilinës dhe nëse situata në vazhdim plotëson përkufizimin e një "ngjarjeje madhore" siç parashikohet në Rregulloren (BE) 2022/123, dhe pasojat dhe vlerën e shtuar që kjo do të kishte në drejtim të zbutjes së këtyre mungesave. MSSG arriti në përfundimin se aktualisht kjo situatë e vazhdueshme e mungesës nuk konsiderohet të jetë një ngjarje e madhe dhe se masat aktuale lehtësuese po përmirësojnë situatën e furnizimit në afat të shkurtër. Duke pasur parasysh përmirësimet e vërejtura për disa nga treguesit nga disa Shtete Anëtare, MSSG është e mendimit se masat që po merren aktualisht në të gjithë BE-në po tregojnë efekt dhe angazhohet të vazhdojë dhe të intensifikojë këto përpjekje për një zgjidhje në kohë të situatës. MSSG do të vazhdojë gjithashtu bashkëpunimin e vazhdueshëm në të gjithë BE-në gjatë gjithë vitit për të shmangur një përsëritje të situatës gjatë sezonit të ardhshëm dimëror.

Përveç kësaj, është e rëndësishme që antibiotikët të përdoren me kujdes për të ruajtur efikasitetin e tyre dhe për të shmangur rezistencën antimikrobike. Antibiotikët, përfshirë amoxicilinën, duhet të përkruhen vetëm për trajtimin e infeksioneve bakteriale. Ato nuk janë të përshtatshme për trajtimin e infeksioneve virale si ftohja dhe gripi, ku nuk janë efektive.

TIRANA, 103 vjet kryeqytet i Shqipërisë

Përfundimi i Luftës së Parë Botërore e la Shqipërinë politikisht të paqëndrueshme, me fraksione të ndryshme që luftonin për pushtet politik. Me synimin për të bashkuar shqiptarët në një qeveri të vetme, më 20 janar 1920, atdhetarë nga gjithë Shqipëria u mblodhën në Lushnjë për të diskutuar të ardhmen e vendit. Duke qenë se Qeveria e Durrësit, atë kohë kryeqytet i Shqipërisë, ishte kundër Kongresit të Lushnjës, më 9 shkurt 1920, anëtarët e Kongresit shpallën Tiranën si kryeqytetin e përkohshëm të Qeverisë së tyre. Ata hynë në Tiranë, më 11 shkurt 1920, dhe që nga ajo ditë Tirana do të ishte përherë kryeqyteti i shqiptarëve, duke u shpallur kryeqytet i përhershëm me një akt të Asamblesë Kushtetuese të vitit 1925.

Gjithsesi 11 shkurti vlerësohet historikisht ardhja e qeverisë shqiptare në Tiranë dhe prirja e asaj nga populli tiranas, të cilit iu desh ta mbronte me gjak këtë qeveri. Atë ditë në godinën, e cila ndodhej në fillim të rrugës së Elbasanit, u vendos qeveria shqiptare me kryeministër Sulejman Delvinën.

Më 11 shkurt 1920, populli i Tiranës priti me entuziazëm Këshillin e Lartë dhe Qeverinë, e cila u vendos pikërisht në atë ndërtesë, ku tiranasit kishin ngritur flamurin në vitin 1912.

Autoritetet e larta të shtetit shqiptar që dolën nga Kongresi, në marshimin e tyre (që nisi më 6 shkurt), kaluan në Kavajë dhe në pamundësi për të hyrë në Durrës, i cili ishte i pushtuar nga forcat italiane, u kthyen drejt Shijakut, për të mbërritur në Tiranë.

Arsyet që u vendos të shkohej drejt Tiranës ishin:

- Mosprania e forcave të huaja (pushtuese)
- Pozita gjeografike në qendër të vendit
- Patriotizmi shumë herë treguar i popullsisë së trevës, dhe ndodhja e disa ndërtesave që mund të përdoshin si zyra.

Në këtë rrugëtim të rrezikshëm, rol kryesor pati ministri i Brendshëm, Ahmet Zogu, i cili kishte përkrahësit e tij të armatosur.

Sipas kujtimeve të bashkëkohësve, ka qenë moszmbarsja e tij përballë forcave italiane, (që tentuan t'i ndalonin përfaqësuesit e zgjedhur në Lushnjë), moment kyç për suksesin e kësaj ndërmarrjeje.

Me të mbërritur në Tiranë, Këshilli i Naltë dhe qeveria, më 11 shkurt 1920, mes entuziazmit popullor, e shpallën atë kryeqytet të përkohshëm. Më 1922 Tirana u shkëput si nënprefekturë nga prefektura e Durrësit dhe u bë prefekturë më vete. Më 1923 ajo kishte 12 453 banorë.

Më 1924, Tirana u bë arenë e luftës së brendshme politike, Revolucionit të Qershorit dhe rikthimit të Ahmet Zogut, i cili u vu në krye të shtetit, në fillim si kryetar i Republikës Presidenciale (1925-1928) pastaj si mbret (1928-1939).

Data 11 shkurt, datë në të cilën Tirana u shpall kryeqytet i përkohshëm, është e një rëndësie parësore në historinë tonë kombëtare; kjo zgjedhje lidhet ngushtë me veprimtarinë e dëndur patriotike të tiranasve, para dhe pas pavarësisë.

Për herë të parë emri Tiranë përmendet në vitin 1418, në një dokument venedikas për t'u kujtuar në shekullin



e 15-të nga historiani dhe shkrimtari i madh Marin Barleti.

Si datë e themelimit të Tiranës si qytet në zemër të Shqipërisë merret



PËR HERË TË PARË EMRI TIRANË PËRMENDET NË VITIN 1418, NË NJË DOKUMENT VENEDIKAS PËR T'U KUJTUAR NË SHEKULLIN E 15-TË NGA HISTORIANI DHE SHKRIMTARI I MADH MARIN BARLETI. SI DATË E THEMELIMIT TË TIRANËS SI QYTET NË ZEMËR TË SHQIPËRISË MERRET VITI 1614, KUR ME KUJDESIN E SULEJMAN PASHË BARGJINIT U NGRIT BËRTHAMA E PARË E QYTETIT ME NJË XHAMI, NJË BANJË (HAMAM), NJË FURRË DHE DISA DYQANE.

viti 1614, kur me kujdesin e Sulejman pashë Bargjinit u ngrit bërthama e parë e qytetit me një xhami, një banjë (hamam), një furrë dhe disa dyqane.

Tirana për gati dy shekuj qëndroi nën degën e familjes Toptani nga Kruja. Që nga mesi i shekullit XVII-të Tirana nisi të zhvillohej dhe në të u ndërtua një pazar i pajisur me zejтари të ndryshme.

Po aq të lashta sa edhe vetë qyteti janë edhe dy lagjet, ajo e Mujos dhe e Pazarit që ndodhen në zonën mes qendrës aktuale dhe rrugës së Elbasanit.

Në vitin 1789 nisi të ndërtohej xhamia e Et'hem Beut, në vitin 1830 u ngrit Kulla e Sahatit, në gjysmën e parë të shekullit XIX-të mbi lumin Lanë u ndërtuan dy ura ajo e Tabakëve dhe ura e Terzizjve. Çezmat në Tiranë,

megjithëse të pakta, konsideroheshin si diçka e shenjtë. Mund të përmendim këtu kroin e Banes, çezmën e Kroit të Shëngjinit etj.

Tirana ndodhet 110 metra mbi nivelin e detit dhe ka një shtrirje gjeografike në të njëjtin paralel me Napolin, Madridin dhe Stambollin, si dhe në të njëjtin meridian me Budapestin dhe Krakovin.



MUNDËSIA JOTE TË BËHESH PJESË E FORCAVE SPECIALE, EJA TESTOHU!

Dëshironi të punoni në Repartin më elitë të Forcave të Armatosura Shqiptare, siç është Batalioni i Forcave Speciale në Regjimentin e Operacioneve Speciale?!

Keni vullnetin dhe guxim të sfidoni veten tuaj me stërvitje dhe trajnime, ku do të ndjeheni të vlerësuar më një trajtim financiar të shtuar, mbi vështirësinë e punës që bëni?!

Doni të profilizoheni në specialitete të ndryshme, me njohuritë më të mira për profesionin që do kryeni?!

Dëshironi mundësi të shumta trajnimesh dhe misionesh brenda dhe jashtë vendit, krah për krah me Forcat më elitare të NATO-s?!

Për të pasur të gjitha këto dhe jo vetëm, EJA BËHU PJESË E BATALIONIT TË FORCAVE SPECIALE TË REGJIMENTIT TË OPERACIONEVE SPECIALE!

Kandidatët që do të aplikojnë për të marrë pjesë në Kursin XIV Bazë të Forcave Speciale, të paraqiten pranë personelit të reparteve përkatëse, për të dorëzuar dhe plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, ose ta plotësojnë atë te personeli i Regjimentit të Operacioneve Speciale. Regjistrimet hapen në periudhën 01-10 shkurt 2023.

Zhvillimi i testimit përzgjedhës do të jetë nga data 13-17 shkurt 2023.

Shpallja e kandidatëve fitues do të bëhet me datë 24 shkurt 2023.

Kriteret për regjistrimin e kandidatëve janë:

1. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
2. Të ketë gjatësi trupore mbi 170 cm.
3. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm, pa tatuazhe, mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
4. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatitit B dhe C.
5. Të mos ketë probleme me zemrën, veshkat, mushkëritë dhe mëlçinë.
6. Mosha maksimale për aplikim është 30 vjeç.
7. Të jetë ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura Shqiptare (Oficer, Nënoficer, Ushtar).
8. Kandidatët Oficerë të jenë me gradën N/Toger-Kapiten.
9. Kandidatët Nënoficer të jenë me gradën N/Tetar-Tetar.
10. Kandidatët Ushtar Profesional të jenë me gradën Ushtar I – Ushtar IV, me kushtin që të kenë kryer kursin SIB dhe SIA.

Dokumentet e nevojshme:

1. Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati, ku të përfshihet dhe arsyeja e ndjekjes së kursit.
2. Fotokopje e ID.
3. Të dhënat e personelit sipas formatit ushtarak të firmosur nga Shefi i Personelit të njësisë ku shërben.

Pikë kontakti:

Zyra e Personelit të Regjimentit të Operacioneve Speciale

Cel: 00355684846190

Tel: 532-1044

